



Pranuar / Dorezuar Priljeno/Protato Received/Delivry	22.09	3	viti god year
Organ /Njesia Org./Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SRMSHCK	6204/2023		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1027/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Jeton Koca dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtar, me Flakron Gashi Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.1027/2023 të datës 26.07.2023 të ankueses me adresë banimi: Rruga Komuna e Prishtinës, kundër Vendimit të Departamentit për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës i datës 14.06.2023, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosies së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 22.09.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.1027/2023 e datës 26.07.2023 e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ministria e Punëve të Brendshme, me datë 18.04.2023 ka shpallur konkursin për pozitën "Zyrtar i Misionit Diplomatik" në kuadër të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në të cilin konkurs kishte aplikuar edhe ankuesja e cila për shkak të pakënaqësive me procedurën e zhvilluar të rekrutimit me datë 15.06.2023 përmes e-mailit zyrtar ankesa.kpmschck@rks-gov.net kishte parashtruar ankesën në Këshillin e pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, mirëpo e njëjta ankesë për shkak të problemeve teknike në web-mailin zyrtar është regjistruar në Këshill me datë 27.06.2023 dhe numër protokoli:5354/2023, kundër Vendimi Nr.4/2023 i Departamentit për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshill pretendon akti i goditur më këtë ankesë është në kundërthënie me natyrën vendimmarrëse, ngase përmes të njëjtit është aprovuar ankesa e lidhur me refuzimin e aplikacionit në fazën e verifikimit paraprak sipas Vendimit 05.06.2023 të Divizionit

për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit në kuadër të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, kurse ankueses i ishte refuzuar sërish mundësia që e njëjta të përfshihet në listën e ngushtë për shkak se e njëjta përvojën e deklaruar të punës nuk e ka mbështetur me vërtetime shtesë nga fondi i kursimeve Pensionale apo tatimore, me kërkesën që Këshilli të aprovojë ankesën e ankueses ngase e njëjta pretendon se për të njëjtën konkurs të cilin Ministria e kishte zhvilluar edhe më herët, ankuesja ishte përfshirë në listën e ngushtë për shkak se i plotëson kriteret e kërkuara të pozitës si dhe kualifikimin e kërkuar profesional.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me datë 02.02.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Ministria e Punëve të Brendshme, ndërsa Ministria e Punëve të Brendshme me datë 17.08.2023 ka dërguar përgjigje në ankesë e cila në Këshill është regjistruar me numër prot:1027/2023.

Sipas kërkesës së Kryetarit të Kolegjit për shtyrje të afatit të vendimmarrjes së ankesës së ankueses, kryetari i këshillit me datë 08.09.2023 ka nxjerr vendimin VK/2023 me numër protokoli:6023/2023 përmes të cilit vendim, ankesës së ankueses me shifër A.nr.1027/2023 të datës 27.06.2023 i është shtyrë afati fillestar i vendimmarrjes edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: E-mail i datës 18.09.2023 dërguar nga Sekretari i Përgjithshëm i SKPMSHCK-së për Kolegjin e Këshillit; Ankesën me numër protokoli 5354/2023 e datës 26.07.2023 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mailin e datës 37.06.2023 me korrespondencën e bashkangjitur prej 2 faqesh dërguar nga ankuesja në Këshill; Konkursin e datës 06.04.2023 me numër reference RN00011404; Vendimin e datës 05.06.2023 të Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit; Njoftimin e datës 30.06.2023 të Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit; Ankesën e brendshme të ankueses; Vendimin e datës 04.06.2023 të Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit/Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik; E-mailin e datës 16.08.2022 dërguar nga NJMBN të MPJD-së për ankuesen; Referencën e datës 01.10.2018; Pasqyrën e llogarisë së ankueses lëshuar nga Trusti, CV e ankueses; Kërkesën e datës 02.08.2023; Përgjigjen në kërkesë të datës 17.08.2023; Listën e aplikantëve; Njoftimi për përpilimin e listës së ngushtë e datës 05.06.2023; Njoftimi i plotësuar për përpilimin e listës së ngushtë i datës 14.06.2023; Vendimin për Themelimin e Komisionit të Pranimit i datës 10.05.2023 me numër:05/142; Aplikacionin e ankueses të datës 27.04.2023; Diplomën e ankueses të datës 26.12.2018 me numër:179-12/2018; Çertifikatën e ankueses lëshuar USAID/ gusht 2017; Letër referencën e datës 01.04.2019; Referencë e lëshuar nga Alko Impex; Referencë e datës 30.09.2018; Kopje e pasaportës së ankueses; Vlerësimi rezultateve në punë për ankuesen për vitin 2022 lëshuar nga Alko Impex; Vlerësimi rezultateve në punë për ankuesen për vitin 2021 lëshuar nga Alko Impex; Vërtetim të lëshuar nga Alko Impex; Çertifikatë e lëshuar nga British Council; Çertifikatën e datës 05.04.2023 lëshuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës; Çertifikatën shëndetësore me shifër CM0201 e datës 13.07.2022; Vërtetimin e datës 25.07.2022 lëshuar nga Komuna e Prishtinës; E-mailin e datës 18.09.2023 përcjell nga DMZP për Këshillin me provat e bashkangjitura të kandidatëve në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankueses është e pabazuar, sepse:



Kolegji i Këshillit në bazë të shkresave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë ka gjetur se Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/Ministria e Punëve të Brendshme përmes konkursit të datës 06.04.2023 ka shpallur konkursin-pranim, për grupin "*Specialistë të Përgjithshëm të Shkencave*" pozitën "*Zyrtar i Misionit Diplomatik-klasa/profesional 2*" në kuadër të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në të cilin konkurs sipas shkresave të lëndës konstatohet se kishe aplikuar ankuesja Magi Ademi, të cilës sipas Vendimit të datës 05.06.2023 të Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit/DMZP i është refuzuar aplikacionin në fazën e verifikimit paraprak me arsyetimin se e njëjta nuk kishte ofruar dëshmi me afat të zotësisë së veprimit dhe dëshmi mjekësore të kërkuara sikur në konkursin e shpallur.

Ankuesja e pakënaqur me refuzimin e aplikacionit ka parashtruar ankesë të brendshme, ndërsa Divizioni për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit/DMZP përmes Vendimit të datës 14.06.2023 me shifër Nr.4/2023 i ka aprovuar pjesërisht ankesën e ankueses, ashtu që aplikacioni i ankueses është refuzuar sërish mirëpo arsyetimi vendimit paraprak ka ndryshuar duke lënë të nënkuptojë se ankuesja ka ofruar dëshmi se e njëjta ka zotësi të veprimit dhe dëshmi mjekësore, mirëpo e njëjta nuk kishte afruar dëshmi të mjaftueshme mbi përvojën e punës në fushën e kërkuara të përgjegjësi për pozitën e punës për të cilën është duke u zhvilluar procedura e rekrutimit, respektivisht pozitën "*Zyrtar i Misionit Diplomatik*" në kuadër të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Nga shkresat e lëndës, Kolegji i Këshillit ka gjetur se sipas konkursit të datës 06.04.2023 për pozitën e punës "*Zyrtar i Misionit Diplomatik*", kërkesat e përgjithshme formale kanë qenë si në vijim:

- *Arsimi i kërkuar*: Diplomë/a e arsimit të lartë më së paku tre (3) vite të studimeve në *Shkenca Politike/Administratë Publike/Politika Sociale/Juridik*.
- *Përvoja e punës së kërkuar*: Së paku një (1) vit përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.

Me qëllim të verifikimit paraprak nëse konkursi i shpallur ka qenë në pajtueshmëri me dispozitat e ligjit material, Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat e Rregullores Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil të Kosovës ndërlidhur me Shtojca Nr.01-Përshkrimi i përgjithshëm i punës për secilën klasë në shërbimin civil të Kosovës dhe Shtojca Nr. 2: Grupet Tip të administrimit të përgjithshëm dhe posaçëm ka gjetur se: "8. Gr. Specialist i përgjithshëm i shkencave politike-Profesional 2; *Arsimi i kërkuar*- *Shkenca Politike/ Administratë Publike /Politika Sociale/Juridik*; *Përvoja e punës e kërkuar*: Së paku 1(një) vit përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës, nga rrjedh se konkursi në fjalë ndërlidhur me përcaktimin e kualifikimit profesion dhe përvojën e kërkuar për pozitën e përcaktuar si më lartë është shpallur në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara ligjore sipas dispozitave të aplikuar të Rregullores Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil.

Kolegji i Këshillit me qëllim të vlerësimit të arsytimit të aktit të goditur nga ankuesja mbi bazën e së cilit të njëjtës i ishte refuzuar aplikacionin në fazën e verifikimit paraprak, ka analizuar aplikacionin e ankueses dhe ka gjetur se e njëjta posedon diplomën e datës 26.12.2018 me shifër:179-12/2018 sipas së cilës dëshmohet se ankuesja e ka përfunduar Kolegjin ESLG në programin Juridik dhe Menaxhimi i Patundshmërive dhe Infrastrukturës duke fituar gradën: *Bachelor i Arteve në Juridik dhe Menaxhimin i Patundshmërive dhe Infrastrukturës*, kurse sipas Referencës së datës 01.04.2019 konstatohet fakti se e njëjtë ka qenë e angazhuar në Komunën e Prishtinës në cilësi të



praktikantes nga data 01.02.2015 deri me datë 31.06.2023 në kuadër të arkives dhe sportelit, sipas Referencës së datës 30.09.2018 ka qenë në marrëdhënie pune me kompaninë StudioForma në pozitën e punës "administratore e zyrës" dhe sipas Referencës së datës 31.03.2023 e njëjta ka qenë në marrëdhënie pune me kompaninë Alko-Impex General Construction në pozitën e punës "juriste", nga rrjedh se e njëjta ka më shumë se 1 (një) vite përvojë pune, mirëpo përvoja e punës sipas përshkrimit nga referencat e lartcekura nuk është në fushën për të cilën zhvillohet procedura e rekrutimit "Zyrtar i Misionit Diplomatik", madje përvoja e punës së deklaruar nuk është e përafërt apo e ngjashme me misionin, titullin dhe funksionin për pozitën për të cilën është zhvilluar procedura e rekrutimit sipas konkursit të datës 06.04.2023.

Prandaj, nga se u tha si më lartë në arsyetimin e këtij Kolegji i Këshillit konstatoi se akti i goditur nga ankuesja, respektivisht Vendimi i datës 14.06.2023 me shifër Nr.4/2023 i Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit/DMZP është nxjerrë në pajtueshmëri me dispozitat e nenit 15 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës si dhe në pajtueshmëri me nenin 132 paragrafi 3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, prandaj mbi këtë bazë dhe konstatimeve si më lartë, ankesa e ankues është e pabazuar sikurse në dispozitivin e këtij vendimi.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

Lënda me numër A.nr.1027/2023

Flakron GASHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/MPB;
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Arkivit të KPMSHCK-së